

# Çështje të klasifikimit të modalitetit në gjuhën shqipe

Mr. Agim Spahiu

24 nëntor 2001

## Përmbledhje

Në këtë shkrim jemi marrë me çështjen e modalitetit gjuhësor, një çështje kjo jo shumë e trajtuar dhe e përkufizuar sa e si duhet në gramatikat e gjuhës shqipe e më gjerë. Pastaj, në fund kemi sjellë një listë të fjalëve e të togjeve të fjalëve të ndërmjetme, por edhe fjalive të këtij lloji, që, në të folur, e kanë intonacionin e vet të theksuar, ndërsa në të shkruar, në njësitë kumtuese- sintaksore, vihen zakonisht në mes presjesh. Këtë listë e kemi sajuar me ndihmën e programeve të caktuara të linux-it, duke u mbështetur në **Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe** të vitit 1980, sipas radhitjes alfabetike.

Modaliteti është një term që përdoret në disa fusha të dijes, por dhe në atë të gjuhësisë. Termin **modalitet** në gjuhësinë shqiptare e gjejmë përgjithësisht të përkufizuar si qëndrim i folësit ndaj asaj që kumton, në lidhje të ngushtë me realitetin objektin, realizuar me mjete të ndryshme gjuhësore - shprehëse dhe intonacionore. Nga kjo del se modaliteti është një kategori e rëndësishme gjuhësore me një shtrirje madje edhe përtej saj. Mirëpo, sa i përket çështjes së studimit të tij në gjuhësinë shqiptare, mund të themi se kjo çështje ka mbetur paksa prapa, për dallim nga gjuhët e tjera, ngase, më sa dimë ne, te ne ende nuk është bërë objekt i një trajtimi të veçantë, e në mënyrë të gjithanshme.

Si term dhe si kategori gjuhësore përmendet aty- këtu në gramatikat tona universitare të viteve të fundit (është fjala këtu për tekstet universitare *Gramatika e gjuhës shqipe I*, - *Morfologjia*, botuar më 1995 dhe *Gramatika e gjuhës shqipe II*, - *Sintaksa*, botuar më 1997 nga ASHSH - ja), por pa ndonjë klasifikim i caktuar për të.

Në **Gramatikën e gjuhës shqipe I** modaliteti përmendet te foljet dhe te pjesëzat. Te kategoria leksiko- gramatikore e foljes, aty në një shënim të shkurtër në fund të faqes, thuhet se qëndrimi i folësit mund të shprehet me anë të mënyrave të foljes dhe me anë të foljeve me vlerë modale<sup>1</sup>. Aty thuhet se vlerë modale kanë foljet: mund, e ndjekur nga një folje në mënyrën lidhore; duhet (a lipset), e ndjekur nga një folje në pjesore ose në lidhore; do, e ndjekur nga një folje në pjesore; kam e jam, të ndjekura nga forma e pashtjelluar e tipit për të larë<sup>2</sup>. Me anë të foljeve modale: mund + lidhore, thuhet më

---

<sup>1</sup>Shih tekstin, f. 261.

<sup>2</sup>Po aty, f. 261.

tejt në këtë tekst, shprehet modaliteti i mundësisë; duhet (a lipset) + lidhore a pjesore; me do + pjesore shprehet modaliteti i detyrimit a i domosdoshmërisë etj. Foljet me vlerë modale në fjali e humbasin mëvetësinë e tyre si folje të zakonshme, dhe, si rrjedhim, po të merren të shkëputura nga togfjalëshi ku bëjnë pjesë, nuk kanë mundësi të kryejnë funksionin e kallëzuesit. E gjithë kjo është sqaruar më mirë nëpërmjet këtyre shembujve, si: Vetëm një pendë poetike mund të përshkruajë meritat e tyre; Njëri prej të dyve duhej të thyhej; Ata janë djem të mirë dhe duhen ndihmuar; Vrulli i tyre vetë do drejtuar, do mbërthyer në vendin e duhur e atëherë ai do të bëjë çudira<sup>3</sup>.

Ndërkaq, te kategoria leksiko- gramatikore e pjesëzës grupi i veçantë i pjesëzave modale, të cilat, sipas autorëve të këtij teksti, po ashtu, shërbejnë për të shprehur qëndrimin e folësit ndaj një a më shumë mendimeve, ndaj vërtetësisë së një ngjarjeje a dukurie të realitetit objektiv<sup>4</sup>. Këtu janë përfshirë pjesëzat:

- a) **pohuese:** *po, posi, po që po, po se po, si urdhëron* etj.;
- b) **mohuese:** *jo, mos, nuk, s', jo që jo, jo se jo, as që* etj.;
- c) **pyetëse:** *a, ë, e; ç) dyshuese: gjë, kushedi, kushedi, mbase, ndoshta, sikur, vallë* etj., dhe
- d) **zbutëse:** *pa, as, le, para, dot* <sup>5</sup>.

Synimi ynë është që nëpërmjet këtij shkrimi t' i sqarojmë në vija të përgjithshme llojet më kryesore të modalitetit, me qëllim që të kemi një pasqyrë më të qartë për to, por pa ndonjë pretendim shterues, sepse për një çështje si kjo mund të bëhen studime me qindra faqe e të mos thuhet të gjitha.

Duke e marrë për bazë qëndrimin e folësit ndaj asaj që kumton, në shumë gjuhë, pra edhe në gjuhën tonë, mund të bëhet fjalë përgjithësisht për: **modalitetin objektiv** dhe **modalitetin subjektiv**.

**Modalitetit objektiv**, siç u tha edhe më lart, mund të shprehet me anë të mënyrave të foljeve të cilat ndryshojnë nga gjuha në gjuhë. Kjo do të thotë se ky modalitet është i lidhur ngushtë me trajtat e ndryshme foljore që zgjedhohen. Sipas Gramatikës së gjuhës shqipe I, me anë të kategorisë gramatikore të mënyrës folësi shpreh qëndrimin e tij ndaj veprimit të emërtuar nga folja duke e paraqitur atë si të vërtetë, të mundshëm, të dëshirueshëm etj<sup>6</sup>. Në grupin e parë, thuhet më tutje, hyjnë mënyra dëftore dhe habitörja, që shprehin kryesisht modalitetin e vërtetësisë; në grupin e dytë hyjnë mënyra lidhore dhe kushtörja, që shprehin kryesisht modalitetin e mundësisë; ndërkaq, dëshirorja dhe urdhërorja shërbejnë për të shprehur modalitetin e dëshirës, e para në formë urimi ose mallkimi dhe e dyta në formë urdhri a kërkese<sup>7</sup>.

Për mendimin tonë, ky lloj modaliteti mund të shprehet edhe me anë të togjeve të foljeve, si p. sh.: *është e mundshme (e mundur), është e nevojshme, është e domosdoshme*

<sup>3</sup>Po aty, f. 262- 264 etj.

<sup>4</sup>Po aty, f. 419.

<sup>5</sup>Po aty, f. 419 - 424. etj.

<sup>6</sup>Shih vep. e cit., f. 272.

<sup>7</sup>Po aty, f. 273.

+ lidhore; është e udhës + lidhore, si në ndërtimet: **Është e mundur të thuhet edhe kështu:** ... ; *Është e nevojshme të theksohet edhe kjo çështje; Është e udhës të vizitohet edhe ky vend historik*; etj.

Po kështu, kjo kategori gjuhësore mund të shprehet edhe me anë të foljeve ndihmëse kam e jam + një paskajore, si p. sh.: Unë kam për të shkuar nesër në atë vend; Ata kuaj nuk janë për të shëtitur, por për të punuar; etj.

Edhe në **Gramatikën e gjuhës shqipe II** përmendet shkurtimisht modaliteti i fjalive kur flitet për llojet e kumtimit. Aty, në mes tjerash, thuhet se fjalitë dëftore e pyetëse, sipas qëndrimit të folësit ndaj realitetit të pasqyruar prej thënies, mund të kenë ngjyrimë modale të ndryshme. Përveç fjalive më të zakonshme që flasin për fakte reale, ka edhe fjali që tregojnë mundësi a pamundësi, supozim, pasiguri a dyshim, domosdoshmëri etj.: Kjo dhembje s' durohet më. (pamundësi). A kalohet këtej? (mundësi). Nga t'ia mbaj? - tha më vete ai. Mos vallë korrieri të dërgoi kot këtu? (pasiguri). Do të ketë dalë ndër miq. (supozim). - Do të kenë prerë ndër lidhjen? - thirri. (supozim) <sup>8</sup>.

Në anën tjetër, **modaliteti subjektiv** ka të bëjë me qëndrimin subjektiv të folësit për një gjë që është e vërtetë, e mundshme, e domosdoshme, e supozuar etj. nga realiteti objektiv. Prandaj, mjetet gjuhësore që i përdorin folësit për të shprehur këtë intencë, janë fakultative. Them i se janë fakultative ngase ato edhe po t' i shmangim krejtësisht nga përdorimi, nuk u prishet kuptimi i elementeve të mbetura të njësisë sintaksore: Krahaso: Më sa shoh unë, çdo gjë shkoi si duhet. (= Çdo gjë shkoi si duhet).

Në të folur, të gjitha ndërtimet që e shprehin këtë lloj modaliteti, shqiptohen me një intonacion krejt tjetër nga njësia kumtuese që ngërthen më vete një vlerë modale objektive. Ato shqiptohen me një ton më të ulët dhe me një ritëm pakëz më të shpejtë nga ai i fjalisë ose nga pjesa tjetër e fjalisë. Dhe kjo gjë mund të krijojë përshtypjen se ato kanë vlerë shtesore, si elemente të dorës së dytë etj. Kurse në të shkruar, në të shumtën e rasteve, ato veçohen me anë të presjeve.

Ky lloj modaliteti mund të shprehet kryesisht me fjalë e togje fjalësh të ndërmjetme, si p. sh.: *sigurisht, me siguri, domosdo, patjetër, pa fjalë, pa frikë, me çdo kusht, vërtet, në të vërtetë, ndoshta, kushedi, vetëkuptohet, siç duket, sipas të gjitha gjasave, pa dyshim, në fakt, me të drejtë, natyrisht* etj., që, bazuar në kuptimin e tyre, ato përgjithësisht shprehin shkallën e vërtetësisë së kumtimit, si plotësisht të vërtetë, të domosdoshëm, të padyshimtë, ose si të mundshëm. Ja disa shembuj me to: Në të vërtetë, ata nuk kishin qenë asnjëherë në pozitë kaq të vështirë; Sigurisht, ata flasin për planin e punës për nesër; Për nder, ke të drejtë! etj. Pastaj, disa të tjera si p. sh.: fatmirësisht, fatkeqësisht, çudi, çuditërisht, për çudi, për fat të mirë, për fat të keq, për mrekulli, (si) për inat, ç' e do etj., që tregojnë vlerësim emocional të kumtimit, duke shprehur gëzim, kënaqësi, hidhërim, pikëllim, keqardhje, çudi, inat, zemërim etj. Ja disa shembuj: Për çudi, asnjë nuk këndonte; Për fat të mirë, ti nënës s' më ke rritur frikacak; etj. ; Disa të tjera, si: para së gjithash, mbi të gjitha, aq më tepër, në mënyrë të veçantë, kryesisht, në radhë të parë, së paku, etj., që tregojnë shkallën e rëndësisë së një fakti, japin vlerësime subjektive të shkallëzimeve të ndryshme të rëndësisë, të peshës që ka një fakt i dhënë në krahasim me një fakt tjetër ose me fakte të tjera. P. sh.: Mos harro se, para së

---

<sup>8</sup>Vep. e cit., f. 118.

gjithash, ne jemi qytetarë; Ajo ishte tani studente dhe, për më tepër, mësonte për letërsi, në atë degë që e kishte ëndërruar vite më radhë; Lexuesin e njohin kryesisht si poet; etj; Disa të tjera si: përveç kësaj, krahas kësaj, ndër të tjera, përkundrazi, sidoqoftë, ndërkaq, në këto rrethana, së pari, së dyti, e dyta, një, dy, nga njëra anë, nga ana tjetër, fundi i fundit, më në fund, si rrjedhim, rrjedhimisht, për pasojë, bie fjala, për shembull, ta zëmë etj., të cilat tregojnë lidhje logjike midis pjesëve të kumtimit, si dhe midis kumtimit dhe një kumtimi të mëparshëm, shërbejnë për të saktësuar, kufizuar, konkretizuar, sqaruar, caktuar pjesë të fjalisë ose tregojnë kundërvënie, krahasim, lejim, përfundim, përgjithësim e rikujtim të thënies etj. Ja përdorimi i tyre në disa shembuj: Flamurin do ta fitojë ai që, përveç të tjerash, do të kursejë më shumë; Mua, për shembull, s' më kenë kritikuar asnjëherë; Fundja, jeta është e mrekullueshme! Mund të isha bërë, bie fjala, peshkatar; etj. Pastaj disa fjalë e togje fjalësh të tipit si: sipas mendimit tim, sipas tij, sipas teje, sipas njoftimeve, për mendimin tim etj., që tregojnë burimin e kumtimit se i kujt është një mendim, ku e ka burimin një shprehje e caktuar etj. P. sh.: Ai hedh parullën e rikrijimit të Lidhjes së vitit 1878, lidhje që, sipas tij, kishte nisur të përtërihej me të vërtetë; Ti je agronom, po njerëzit duhet t' i njohësh dhe, sipas mendimit tim, nuk ka rast më të mirë se puna; etj. Disa të tjera, si: me një fjalë, shkurt, më mirë, më saktë, me pak fjalë, me fjalë të tjera, ndryshe etj., që karakterizojnë qëndrimin e folësit ndaj mënyrës së formulimit, ndaj përdorimit të një fjale a të një shprehjeje në vend të një tjetre. P. sh.: Më pak fjalë, kështu ne jemi në gjendje të ndihmojmë njëri - tjetrin; Shkurt fjala, bujqësia do punë; Po mungesa e analizave shoqërore ose, më saktë, pamjaftueshmëria e këtyre analizave, rendja pas ngjarjeve e kanë dëmtuar vlerën realiste të romanit; etj. ; Dhe, së fundi, disa që përdoren për t' ia tërhequr vëmendjen bashkëbiseduesit për atë që thuhet më pas, për ta theksuar atë, për të shkaktuar ndonjë reagim ndaj kumtimit. Të tilla janë, si: të lutem, që thua, që thua zotrote, ama, do ti etj. si p. sh: Po, të lutem, hidhu sa të mundesh një kolonjë njerëzve që të vizitojnë; Ai djaloshi, që thua zotrote, është një shejtan nga unë e nga ti; Të lumtë, po, as më thua, janë të vërteta këto, moj zonjë; <sup>9</sup>. Mirëpo për këto njësi asnjëherë nuk është thënë se përdoren me vlerën e modalitetit, por vetëm si njësi jashtë lidhjeve sintaksore me gjymtyrë të fjalisë. Më shumë për këtë shih tekstin e përmendur f. 355 - 375 etj.

Për analogji me këto, edhe fjalitë e ndërmjetme bartin në vete modalitetin subjektiv. Ja p. sh: Kishim ndryshuar, kjo s' do mend, po gjallëria e viteve të shkollës vlonte gjithnjë në zemrat; Por, kuptohet vetvetiu, është vështirë të flitet për karakterin tërësisht shkencor të të gjithë këtyre punimeve; Në mos gabohem, ne u takuam te ura e kanalit të madh; Siç thotë edhe populli, dita e mirë shihet që në mëngjes; Unë u tremba, të them sinqerisht; Që të mos e zgjatim, e vazhduam bisedën atë natë gjer vonë; Sikundër thamë më sipër, shqiptarët gjithmonë janë vrarë e përpjekur për lirinë<sup>10</sup>.

Modaliteti subjektiv mund të shprehet edhe me anë të disa pjesëzave, si në shembujt: Bile, fanatizmi është trashëguar nga e kaluara; Madje, ai qysh tani na e ka nevojën; Mos more, qenka i zgjuar! <sup>11</sup>.

<sup>9</sup>Shembujt me sqarime janë marrë nga njësia **Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme** të tekstit *Gramatika e gjuhës shqipe* II, f. 355- 375.

<sup>10</sup>Po aty, f. 639 - 647. etj.

<sup>11</sup>Po aty, f. 418- 421 etj.

Në gjuhën tonë kjo kategori gjuhësore mund të realizohet edhe me mjete të tjera periferike si, bie fjala, me fjalitë njëkryegjymtyrëshe, pasive, të paplota, me pasthirrma, me aspektin foljor, me intonacion (p. sh.: intonacioni dëftor i gërshetuar me atë thirrmos) etj., për çka kjo kategori gramatikore, semantike e pragmatike meriton një trajtim të veçantë e të gjithanshëm nga ana e studiuesve të gjuhësisë sonë.

Këtu më poshtë, me anë të programeve të caktuara të linux-it, kemi arritur ta selekcionojmë dhe ta krijojmë një fjalorth të fjalëve, togjeve dhe të fjalive të ndërmjetme nga **Fjalori i gjuhës së sotme shqipe** të vitit 1980, sipas radhitjes alfabetike.

- AFËRMENDSH** ndajf. Kuptohet vetvetiu, është e qartë vetvetiu, s'ka dyshim. Do të vonohej, afërmendsh, po të nisej më këmbë.
- ANI** bised. I. ndajf. Nuk ka gjë, s'prish punë, paçka. Ani, do të pres. Ani se nuk erdhi.
- AQ** I. ndajf. Jo vetëm aq. përdoret për të treguar se përveç atyre që u përmendën ka edhe të tjera, se ajo që u tha duhet shtuar e plotësuar. Aq me bën! nuk çaj kokën, nuk pyes. Aq (kaq) dua! këtë pres, kjo me duhej për të vepruar pastaj si di vetë. Aq qe! ajo u desh, vetëm ajo sikur pritej.
- ASNJË** pakuf. Pa asnjë dyshim (s'ka asnjë dyshim). patjetër, medoemos.
- ASHTU** ndajf. Përdoret në fillim të fjalive që përmbyllin një mendim, me kuptimin: kështu, atëherë. Ashtu, u ngrit e hapi derën.
- BELI** ndajf. thjeshtligj. Siç duket, me sa duket.
- DEMEK** pj. bised. Domethënë; pra (përdoret zakonisht në fillim të një fjalie për të përmbledhur atë që ka thënë dikush më përpara). Demek, ne nisemi nesër. Demek, i mbarove të gjitha. Demek, kështu thua ti!
- DOEMOS** ndajf. Natyrisht, pa dyshim, vetëkuptohet. Doemos, atij i binte të fliste. Kush punon mirë, doemos, do të shkojë përpara.
- DOMETHËNË** lidh. Përdoret në fillim të fjalive që përmbyllin një mendim, me kuptimin «pra, si përfundim, atëherë, kështu». Domethënë, vendose të ikësh. Domethënë, mbaroi kjo punë.
- DOMOSDO** ndajf. Kuptohet vetvetiu, pa dyshim, vetëkuptohet, natyrisht, ta merr mendja. Të rinjtë, domosdo, qenë të gjithë të gatshëm.
- DREJTË** f. Ç'është e drejta (e vërteta), shih te VËRTET/Ë, A (e). Të them (të themi) të drejtën (të vërtetën), shih te VËRTET/Ë, A (e).
- DUKEM** vetv. Siç duket... Me (nga) sa duket...
- DYSHIM** m. Sigurisht, me siguri, patjetër. S'ka dyshim që... (se...) me siguri që..., sigurisht që..., patjetër që... Ka një dyshim të vogël. Ka shumë dyshim. E ha (e bren, e mundon) dyshimi. Shpreh (heq) dyshimin. S'lë asnjë dyshim. Vë (vihet) në dyshim. Bie në dyshim. Pret (sheh) me dyshim. Lëri dyshimet!
- DYTI** ndajf. Në radhë të dytë (edhe si fj. ndërm.).
- GJITHSESI** ndajf. Sidoqoftë. Gjithsesi, duhet ndjekur. Gjithsesi, na njofto si vajti puna.
- HELBETE** Sigurisht, me siguri, pa dyshim; e po, natyrisht. Po, helbete, njerëz jemi. Ajo po dihet, helbete. Helbete, dimër i thonë. Helbete, është djalë i ri.
- HESAP** m. bised. Shkurt hesapi. shih te SHKURT.
- INAT** m. bised. Për inat (si për inat), për fat të keq, për dreq. Për inat të dikujt për të zemëruar a për të inatosur me qëllim dikë. Sa inat! sa keq!

- JAM** jokal. Ç'është e vërteta (e drejta), shih te VËRTEET/Ë, A (e).
- KAQ** I. ndajf. Jo vetëm kaq, përdoret për të treguar se, përveç kësaj që po thuhet, ka edhe të tjera, se kësaj që po thuhet i duhet shtuar diçka.
- KËSHTU** ndajf. Përdoret në fillim të fjalive që përmbyllin një mendim, me kuptimin «pra, si përfundim, atëherë». Kështu pra. Kështu, u ngrit dhe iku. Kështu, ju do të vini. Kështu, u morëm vesh. Kështu, nuk ka përse të shqetësoheni.
- KRYEKREJE** ndajf. Në krye, në fillim, para së gjithash, mbi të gjitha (edhe si fj. ndërm).
- KUSHEDI** ndajf. Mbase, ndoshta, mundet. Mbledhja, kushedi, bëhet nesër. Merre, kushedi, të duhet. Kushedi, mund të vijë. Kushedi, mbase e pranon. Ndofta i mbushet mendja, kushedi.
- MBANË**. I. ndajf. Mbanë tjetër, nga ana tjetër, përveç kësaj.
- MBASANDAJ** ndajf., shih PASTAJ. Eja mbasandaj. Mbasandaj, ju e patë edhe vetë.
- MEAZALLAH** ndajf. bised. Përdoret për të shprehur dyshim, mosbesim a pasigurt ose për të përforcuar një mohim. Po sikur, meazallah, të vritet? Jo, meazallah, si mund ta bëj këtë. Meazallah, nuk tundet nga vendi.
- NATYRISHT** fj. ndërm. Pa dyshim, siç është e natyrshme, sigurisht. Natyrisht, nuk qe punë e lehtë. Ju, natyrisht, këtë e kup-toni vetë.
- PARA** f. Së pari.
- PARI** ndajf. Përdoret për të shënuar pikën ose çështjen e parë që përmendim me gojë a me shkrim. Së pari...; së dyti...
- PASOJË** f. Si (për) pasojë ..., rrjedhimisht, prandaj, për rrjedhim.
- PATJETËR** ndajf.  
Pa asnjë dyshim, me siguri. Ju, patjetër, e keni marrë vesh. Ai ishte, patjetër, unë e pashë mirë.
- PËRFUNDIMISHT** ndajf. Shkurt, si përfundim. Përfundimisht, nuk e pashë më.
- PRA** pj. Përdoret për ta bërë më të gjallë e më të bukur të folurit, duke theksuar më shumë kuptimin e fjalës a të fjalisë, me të cilën lidhet. Merre pra! Eja, pra, se na vonove! Ndale, pra, makinën! Pikërisht në këtë vend, pra, takuam kryetarin e kooperativës.
- PRERË** ndajf. Patjetër, pa dyshim. Prerë, (që) do të niset.
- RRJEDHIM** m. Si (për) rrjedhim, domethënë, në këtë mënyrë, rrjedhimisht, prandaj, pra. Si rrjedhim i ... nga, për shkak se, si pasojë e ...
- RRJEDHIMISHT** Si pasojë e diçkaje tjetër, për rrjedhim, domethënë, për pasojë. Rrjedhimisht, janë rritur të ardhurat e kooperativistëve. Rrjedhimisht, në krye doli klasa punëtore. Edhe të metat, rrjedhimisht, u pakësuan.
- SIDOKUDO** ndajf. Sido që ta jetë, sido që ta marrësh. Sidokudo, një më të madhi nuk i flitet ashtu. Sidokudo, jemi shokë dhe duhet të bashkëpunojmë.
- SIDOQOFTË** Sido që të jetë puna, pavarësisht nga ndonjë rrethanë a si ka qenë, prapëseprapë. Sidoqoftë, ai kishte punuar shumë. Sidoqoftë më nuk do të mungojmë (nuk do të heshtim). Sidoqoftë, ka ardhur koha të zgjidhet kjo çështje.
- SIGURISHT** ndajf. Pa dyshim, kuptohet vetvetiu. Ju, sigurisht, jeni marrë vesh me të.
- SHKRETË** mb. përd. em. f. Përdoret zakonisht kur duam të përforcojmë urdhrin dhe të tregojmë se e kemi humbur durimin, se është kapërcyer kufiri për një gjë etj. Pusho një herë, të shkretën! Çlodhu pak të shkretën! Jepja de, të shkretën! Ah, të shkretën, që s'eci dot. Po mjaft de, të shkretën! Ç'e harrova, të shkretën!

**SHKURT** ndajf. Që ta themi me pak fjalë, që të mos e zgjatim (përdoret në krye të një fjalie kur rimerret e përmblihet me pak fjalë ajo që është thënë më parë). Shkurt, aty ka pasur një frymë të lartë luftarake. Shkurt, nuk kthehem dot para shtatorit. Shkurt hesapi...

**SHOH** kal. Ke parë ti..., përdoret kur shprehim habi për diçka që nuk e pritnim të ndodhte a që s'e kemi menduar.

**THEM** kal. Në sh. Ta zëmë, për shembull. Ishin, të themi, nja dyqind vetë. Vinin, të themi, për ditë. Më mirë, të themi, e gjetëm vetë. Si të themi. . . si për shembull.

**VËRTET** I. ndajf. Është e vërtetë, me të vërtetë, të themi të vërtetën, ç'është e

vërteta. Puna, vërtet, të lodh, po të jep kënaqësi të madhe. Vërtet, e vonoi ca, po e ka bërë shumë të bukur.

**VËRTETË** f. Me të vërtetë, vërtet. Ç'është e vërteta (e drejta...), përdoret për të theksuar atë që thuhet, me kuptimin «në të vërtetë, pa dyshim; sigurisht». Të them (të themi) të vërtetën, përdoret për të theksuar më shumë vërtetësinë e asaj që thuhet, me kuptimin «sigurisht, vërtet».

**XHANËM** pj. Përdoret kur shprehim kënaqësi ose habi, kur bëjmë vërejtje për diçka që nuk na pëlqen ose kur jemi të detyruar ta pranojmë pa qejf diçka a të bëjmë një lëshim; të shkretën. Si s'merr vesh, xhanëm! Lërmë rehat xhanëm! Pse xhanëm? Ku ishte xhanëm? E, xhanëm, ashtu është. Mirë, xhanëm, bëje!